

1. Në intervistën e dhënë në emisionin e shfaqur në Syri TV (<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/videos/vb.1477517792294489/885560245340387/>), Presidenti ka mbajtur qëndrimet si vijon që kanë lidhje me marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës transkriptuar nga shërbimet e Kuvendit:

23.4. 2021 Syri Tv Çim Peka

Ilir Meta: ..Se më tha se duhet të ndaloni për çështjen e sfulqëve dhe unë i thashë: duhet të ndalosh duke mbështetur Ramën për të dhunuar zgjedhjet. Kaq. Po, e thashë edhe këtë gjë dhe do të them edhe gjëra të tjera....E përshëndes ambasadorin dhe po i them se Shtetet e Bashkuara të Amerikës duan zgjedhje të lira dhe demokratike. Nuk duan një gangster në Shqipëri, as një milion shqiptaro-amerikanë atje. Po i them ambasadores atë që i kam thënë ditën e parë që më ka ardhur në zyrë: ajo është përgjegjëse për marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Amerikës. Nuk është për marrëdhëniet midis Serbisë dhe Amerikës. Për marrëdhëniet midis Serbisë dhe Amerikës është ambasadori apo ambasadorja amerikane në Serbi. Kaq. Pikë. Mbaroi historia...Ambasadorja e Amerikës nuk më tregon dot mua se çfarë duhet të bëj unë për llogari të Edi Ramës.

..Ambasadorja e Amerikës nuk më merr mua dot në telefon (po ia them këtu asaj, meqë ia thashë edhe dje) për llogari të Edi Ramës dhe të më thotë një ditë para mbledhjes së një institucioni shumë të rëndësishëm, të KED-së, që të pranoj unë të kthehet përsëri Dvorani në KED, pasi Venecia e tregoi shumë qartë se çfarë është Dvorani. Kaq.Po, ma ka kërkuar këtë gjë. Po e them sot këtu. Ka bërë shumë gabim, sepse e ka bërë për llogari të Edi Ramës jo të Amerikës, se Amerika kërkoi Venecien dhe Venecia e tregoi qartë që Dvorani dhunoi Gjykatën Kushtetuese. Pikë!

,,,Se më tha që kam bërë një deklaratë për punën e sfulqëve. Ça kishte ajo?! Unë i thashë: ndalo për të mbështetur Edi Ramën! I thashë: nëse do të kishte reaguar ti dhe të tjerët për çështjen e Kavajës në kohë, nuk do të kishte ndodhur vrasja në Elbasan. I kam thënë: ke bërë shumë gabim që ke mbështetur Edi Ramën. Ia kam thënë për të prishur marrëveshjen e 5 qershorit. U bë marrëveshja e 5 qershorit? Ky parlamenti, e ke parasysht me 120 e ca deputetë kukulla, ajo mund të bëjë këtë gjë. Kaq.

E duan amerikanët Edi Ramën? Ta marrin në Amerikë, ta bëjnë çfarë të duan, ama këtu në Shqipëri, këtu do të vendosë populli i Shqipërisë. Pikë! Mbaroi historia. Se ne për këtë gjë e duam Amerikën, për zgjedhjet e lira dhe të ndershme, për asgjë tjetër nuk e duam. Po të jetë se kemi frikë nga Amerika se ka aeroplanmbajtëse dhe raketa, duhet të kemi frikë edhe nga Rusia, se ka edhe Rusia. Ka dhe koreano-jugori, por ne nuk e kemi frikë. Ne e duam për demokracinë, për zgjedhje të lira dhe të ndershme. Në Shqipëri është vetëm një kërcënim për zgjedhje të lira dhe të ndershme, është Edi Rama. Nuk është askush tjetër, nuk është as zoti Basha, nuk është as asnjëri tjetër. Mbaroi historia. Pikë.....o, nuk e duan amerikanët Edi Ramën. Edi Rama është në një korrupsion, një lobim ndërkombëtar,

siç rregulloi dhe mori fotografinë me Presidentin Obama si gruaja e Bilalit, bën këto lojëra, këto filmat. Kaq. Amerika nuk i do gangsterët.

...”Kam Shqipërinë të parën, kam ca vende bosh, pastaj kam Amerikën. Dhe Amerikën e dua, për aq kohë sa nuk dëmton Shqipërinë”. Pikë!

Tjetër i kam thënë Amerikës: “Unë te Gjykata Kushtetuese e kam vijë të kuqe, flakë të kuqe”, sepse ne Kushtetutën e kemi bërë bashkë me Amerikën. Dakord? Për qejfin e Edi Ramës, unë nuk bëj gallatë me Shqipërinë! Kjo është.

... E para, ambasadorja ia fut kot, se unë nuk kam thënë “në qoftë se nuk u pëlqen rezultati i zgjedhjeve”, sepse rezultati mund të mos më pëlqejë mua kur unë humbas. Ia ka përkthyer Guri kot, se Guri dihet se ç’është, patronazhist është edhe Guri.

...Këtë të çmendur le ta marrin në Amerikë, po të duan ata, në qoftë se duan! Kaq!

...Zonja e nderuar, kjo më ka thënë mua, që ta dini ju dhe të gjithë shqiptarët, meqë hyri kjo në këtë lojë. Donte të hynte në këtë lojë? Ta bëjmë lojën tamam. Më ka marrë në telefon. Unë kisha bërë një letër, sepse këta donin ta fusnin përsëri në KED Dvoranin, dhe i them: “Thirrini mendjes, sepse ky nuk është as KLGJ, ky është me Venecien...”, e të tjera. Unë e kisha bërë letrën. Nuk do ta botoja letrën në orën 11:00, që ishte mbledhja, sepse nuk doja të ndërhyja, si të thuash, në një vendim të organeve të drejtësisë. Kjo më mori mua në telefon dhe më tha: “Ti ke bërë një letër kështu, ndaj, ti”, më thotë mua: “Zotëri, nesër mos bëj zhurmë nëse këta bëjnë kështu, sepse...” “Moj, zonjë”, i them unë po ne kemi bërë një marrëveshje që do të respektojmë Venecien. Ky nuk është as anëtar; nuk është më anëtar i Gjykatës së Lartë, nuk i takon dhe nuk ka se si të jetë këtu. Jo andej po këtej, më thotë mua: “Ne dimë disa gjëra për ty”. Ambasadorja i thotë Presidentit të Republikës: “Ne dimë disa gjëra për ty?!”.

...Unë nuk e shkel Kushtetutën. Unë nuk e shkel marrëveshjen që kemi bërë bashkë për të respektuar Venecien”. Unë i kam thënë kësaj zonjës, dhe ta dëgjojë ajo tani, meqenëse e porosit Edi Rama të provokojë Presidentin e Shqipërisë dhe të provokojë popullin e Shqipërisë që e do aq shumë Amerikën, për demokraci dhe për liri, jo se ka frikë nga kjo dhe nga ndonjë njeri tjetër. E kisha vendosur që këtë letër mund ta publikoja pas vendimit, nëse ata merrnin vendim të gabuar, që të mos ndërhyja”. Unë tani... I them në orën 11:00 është mbledhja, në orën 10:00 do ta publikoj letrën. Ti dhe Amerika, çfarë keni për mua, publikojeni! Unë nuk e tradhtoj Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Unë tani, këtë vagabond, këtë horr që ti më thua pranoje tani që e ka shkelur dhe e la Shqipërinë pa Gjykatë Kushtetuese nuk pranoj kurrë që ky të vijë atje. Kaq. Kjo është historia.

Unë kam respekt për të. Këto gjëra ia kam thënë edhe dje në takim. Erdhi situata këtu, ta dijë ajo. Unë nuk kam thënë: “Njerëzit të marrin shfurqe dhe të mos njohin rezultatin”, por, nëse preket vota e popullit, siç është kjo tendencë, pa dyshim që populli shqiptar nuk mund ta njohë këtë

rezultat, sepse edhe kolegu i saj, Donald Lu, tha: “Zgjedhjet ishin shumë të mira në Kirgistan...”

Doli populli kirgistan dhe tha ai: “Na falni, por zgjedhjet nuk ishin të mira”.

Ndaj, e dashur ambasadore, që të mos kemi rastin e Kirgistanit: ndiko tek ai i sëmuri psikik që të mos e provokojë më as Presidentin, as popullin...

...Të mbajnë vendin e tyre ambasadat. Janë 100 ambasada. Pikë! Në qoftë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë një problem me Ilir Metën, siç thotë ky qen bir qeni, çuni i Krita Ramës, që vajti dhe u vesh si grua për të bërë një foto të paligjshme, që turpëron çdo njeri normal, jo çdo politikan serioz në Amerikë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës në qoftë se kanë ndonjë gjë me Ilir Metën, meqë thotë ky, nxjerr këta spiunët e UDB-së, Frrok Çupi me shokë...

...në qoftë se kanë ndonjë gjë, po u them Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që jua kam thënë: Ilir Meta nuk mendon që është një njeri i pavdekshëm. S’e ka këtë mendim absolutisht, do të vdesë një ditë si gjithë të tjerët, se ka vdekur Skënderbeu, jo më Ilir Meta. U kam thënë: Në qoftë se keni ndonjë gjë me mua ju më lajmëroni kur e keni, se unë e di që ju edhe më vrisni, i kam thënë. Po të vete te Mali me Gropa dhe më çoni ndonjë raketë që të paktën të mos dëmtoj njerëz të tjerë, se nuk e kam problem, por Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk kanë asgjë me Ilir Metën, se Ilir Meta është politikani më luajal ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës në 30 vjet. Janë qarqe të korruptuara, janë lobingje që i paguan Serbia edhe atje, edhe në vende të tjera, të cilët përdorin përfaqësuesit e Amerikës kundër Ilir Metës.

Në takimin e parë i kam thënë zonjës: “Zonjë, je këtu për marrëdhënie mes Shqipërisë dhe Amerikës, jo mes Serbisë dhe Amerikës”. Ajo nuk do të jetë përgjegjëse për këto marrëdhënie, le të vazhdojë me Edi Ramën dhe me të tjerët, që fusin hundët në punët e Shqipërisë. Kjo është punë e saj, unë nuk e pengoj. Por asgjë nuk e ndryshon qëndrimin e Ilir Metës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pikë, mbaroi historia”.

...Sa herë të reagojë ambasadorja, do të reagoj edhe unë dhe po të dojë ambasadorja, të vijë këtu me gjithë Edi Ramën.

..Ore zotërinj, çfarë ka Amerika dhe Europa për mua, t’i nxjerrin para popullit të Shqipërisë! Do të marrin krahun e gruas së Bilalit, që ka shkelur ligjet Amerikane? Ta marrin. Përse e marrin? Për të shpopulluar Shqipërinë? Për të sjellë bangladeshas? Për të sjellë indianë, duke menduar se ky është një popull që duron e pranon?

2. Ndërsa në emisionin datë 01.03.2021 “Frontline” News 24, Presidenti ka bërë këto deklarime:

“Unë nuk merrem me punët e Amerikës se kemi dikë tjetër që merret me punët e Amerikës dhe gjithë botës. Unë merrem me punët e Shqipërisë. Sesa respekt ka ai për SHBA-të e tregoi kur ua hodhi në fytyrë

marrëveshjen e 5 qershorit. Unë kam shumë respekt për SHBA-të dhe unë jam president i Shqipërisë.

Amerikanët e Edi Ramës Ilir Meta i kap për veshi, jo presidenti se presidenti është tjetër fuqi, se ka fuqinë e popullit shqiptar. E di ai sesi u flas unë atyre kur ata nxijnë dhe bëjnë maskarallëqe për llogari të Edi Ramës. Dhe po i them që të mos i përmendë më ata dhe gënjejë as veten e as ata të mos e gënjejnë se do t'i dalin ata për zot po preku një votë të lirë, se vota është e shenjtë dhe do të jetë e shenjtë nga 25 prilli e për 100 vjet. (<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/videos/495242224798156>)”

3. Rezulton nga qëndrimet sa sipër në emisionin televiziv dhe aktet që u morën në shqyrtim gjatë procesit hetimor se Presidenti i Republikës ka ndërmarrë sulme publike kundër ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) dhe vetë Ambasadores Yuri Kim, duke përhapur akuza të rreme për ndërhyrje në punët e brendshme, për njëanshmëri dhe përfaqësim të interesave antishqiptare të shteteve të tjera, sikurse ka insinuar se autoritetet përfaqësuese të SHBA-së kanë kryer ose janë të aftë të kryejnë krime kundër tij.

4. Të gjitha deklaratimet e tij publike kundër ambasadës dhe autoriteteve përfaqësuese të SHBA-së do kishin forcën të dëmtonin rëndë marrëdhëniet me aleatin tonë strategjik, nëse autoritetet kompetente të SHBA-së nuk do kuptonin se këto qëndrime janë e kundërta e qëndrimit zyrtar të Republikës së Shqipërisë.

5. Pavarësisht kësaj, imazhi dhe pozita ndërkombëtare e Republikës së Shqipërisë, konsiderohet e dëmtuar, për shkak se institucioni i cili duhet të përfaqësojë ndërkombëtarisht Republikën e Shqipërisë (sipas parashikimeve kushtetuese të sipërcituara), bëhet konfliktual, sulmon dhe synon të denigrojë aleatin më të madh strategjik të Shqipërisë. Kjo qasje problematike arrin kulmin kur Shtetet e Bashkuara të Amerikës, konsiderohen si shtet i aftë të kryejë krime.

6. Presidenti i Republikës, i cili ka detyrën të përfaqësojë dhe shprehë qëndrimin e shtetit shqiptar kundrejt aleatit tonë strategjik, vullnetin për t'i thelluar dhe konsoliduar pandërprerë këto marrëdhënie, ka bërë saktësisht të kundërtën, është përpjekur të krijojë krizë dhe incidente diplomatike me SHBA-në. Presidenti i Republikës nuk i ka dëmtuar dot këto marrëdhënie, por ka dëmtuar rëndë autoritetin dhe prestigjin e institucionit të Presidentit në marrëdhëniet me jashtë. Ky autoritet dhe ky prestigj nuk mund të rikuperohet më prej tij, por vetëm nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, i cili ka detyrë të gjejë përgjigjen adekuate ndaj kësaj shkelje të pozicionit kushtetues të Kreut të Shtetit.

7. Është fakt i njohur botërisht se SHBA është një partner dhe aleat strategjik i Shqipërisë, i njohur dhe vlerësuar si i tillë në mënyrë konstante në politikën e përgjithshme të shtetit shqiptar, përcaktuar nga ekzekutivi si dhe në politikën e jashtme dhe marrëdhëniet me shtetet dhe përfaqësuesit zyrtarë të shteteve të tjera që drejtohen nga Kuvendi siç rezulton nga gjithë korpusi i marrëveshjeve përkatëse dypalëshe dhe akteve ligjore të botuara në Fletoren Zyrtare, që pas rënies së regjimit të vjetër diktatorial. Kontributi i SHBA në forcimin e demokracisë, konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe sundimit të ligjit në Shqipëri dhe në shumë fusha të tjera

që ndihmojnë prosperitetin e vendit tonë është i shume i çmueshëm. Bashkëpunimi me SHBA është dhe do të mbetet strategjik dhe me vlera për interesin më të mirë të dy popujve tanë.

8. Gjithashtu rezulton se Presidenti ka mbajtur qëndrime publike dhe kundër përfaqësuesve të tjerë të huaj që punojnë në Shqipëri, por pa përmendur emra shtetesh konkrete, duke shfaqur një qasje ndaj diplomatëve në Shqipëri si të korruptuar apo duke u kërkuar llogari për si duhet të veprojnë në situata të caktuara. Pavarësisht se Presidenti nuk përmend emra apo shtete konkrete, kjo qasje dëmton autoritetin dhe figurën e institucionit të Presidentit të Republikës, si edhe padiskutim që mund të bëhet shkak për të krijuar kriza apo incidente diplomatike:

“22.04.2021 Konferencë për mediet: Kjo është reforma në drejtësi e Edi Ramës që thotë Ilir Meta do ta ndryshonte reformën në drejtësi..... Burimi i tensionit në Shqipëri është Edi Rama i cili ka kapur drejtësinë, do të blejë votat dhe ta bëjë gjithë Shqipërinë Shijak dhe Dibër. U bëj thirrje ndërkombëtarëve të jenë më parimor dhe të reagojnë në kohë. Nëse s’do kishin pranuar shkeljen e marrëveshjes së 5 qershorit situata do kishte qenë më e mirë prej kohësh”.
(<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/videos/187611373206806/>) dhe...”
Ilir Meta nuk pyet për horrat dhe gangsterët, nuk pyet për mafien ndërkombëtare dhe as për diplomatë të korruptuar,
<https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/videos/923298731754050/>

9. Për sa më sipër, Komisioni Hetimor konstaton se **Presidenti nuk ka respektuar nenin 100 dhe 102 të Kushtetutës dhe ka vepruar në tejkalim të kompetencave të veta në nenin 92 të Kushtetutës, rrjedhimisht duke shkelur kështu dhe nenin 88, paragrafi 3 i Kushtetutës, pasi rezulton se ai ka vepruar në kundërshtim me detyrimet kushtetuese në betim për të respektuar Kushtetutën dhe ligjet e vendit.**